20-vjetori i Aleancës Franceze të Tiranës
Tiranë, 12 mars 2012

Zonja Kryetare e Kuvendit,
Zoti Ministër,
Zoti Kryetar i Bashkisë,
Zonja dhe zotërinj Ambasadorë,
Zonja Presidente e Aleancës Franceze të Tiranës,
Zonja dhe Zotërinj,

Sonte përkujtojmë 20-vjetorin e Aleancës Franceze të Tiranës.

Krijimi i saj, në mars 1992, u mbështet mbi një traditë frankofone shumë të gjallë, dëshmi e të cilës janë personalitetet shqiptare të shkencës, kulturës dhe politikës. Një traditë në të cilën zë një vend të veçantë Liceu Francez i Korçës : edhe sot familjet e ish-nxënësve i kanë qendruar besnikë gjuhës dhe kulturës franceze.

Pra në një mënyrë të natyrshme frankofonët shqiptarë dëshiruan, në vitin 1992, ta vazhdonin këtë traditë dhe mbi të gjitha, t'u linin stafetën brezave të rinj.

Dëshiroj të përshendes në mënyrë të veçantë zonjën Presidente, Drita Hadaj, e cila ka qenë me plot kuptimin e fjalës krijuesja e Aleancës në Tiranë, për gjithë guximin, shpirtin e iniciativës e të imagjinatës, si dhe, mendoj unë, për netët pa gjymë të fillimit të punës… Zonja Hadaj, ju e keni shoqëruar Aleancën në rritjen e saj gjatë gjithë këtyre viteve dhe duhet të jeni krenare për atë çka është bërë ajo sot.

Do të doja të bashkoja në këtë përshëndetje Drejtorin Dritan Xhelili , i gatshëm në çdo çast për ide të reja, si dhe të gjithë ekipin e Aleancës, mesuesit dhe personelin mbështetës.

Sepse tipari dallues i Aleancave Franceze në të gjithë botën - kjo përbën edhe forcën e tyre -, është mbështetja në nisma lokale, në personalitete të angazhuara dhe me entuziazëm, plot me dëshirë për të ndërtuar një urë mes vendit të tyre dhe Francës, si dhe më gjërë akoma, për të kontribuar për frankofoninë. Pikërisht duke u mbështetur në këto rrënjë të forta në Shqipëri, si dhe natyrisht me mbështetjen dhe kujdesin e Fondacionit të Aleancës Franceze të Parisit dhe të Ambasadës së Francës, pemët kanë dhënë frytet e tyre më të mira.

Në Shqipëri ashtu si edhe në vende të tjera, roli i Francës është të tregohet në lartësinë e besimit që njerëzit kanë në gjuhën, kulturën dhe vlerat e saj. Mes Aleancës Franceze, Fondacionit Aleanca Franceze Paris dhe Ambasadës së Francës ekziston një partneritet i palëkundur dhe i qendrueshëm.

Jam shumë e gëzuar për faktin se para disa vitesh qeveria franceze e ndihmoi AF të Tiranës të vendoset në ambientet aktuale me një vendodhje shumë të mirë, moderne dhe funksionale, në rrugën e Barikadave.

Jam shumë e lumtur për kontributin e ne të gjithëve së bashku, në sajë të të cilit AF është bërë një stacion i domosdoshëm për të rinjtë që dëshirojnë të ndjekin studimet universitare në Francë, qoftë edhe për të përmirësuar nivelin gjuhësor ose për këshilla orientuese pranë hapësirës Campus-France.

Jam shumë e lumtur për bashkëpunimin e AF me Fondation Alliance Française de Paris, garanci kjo për një nivel të lartë cilësor në mësimdhënie të gjuhës nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të metodave dhe pajisjeve nga më modernet.

Më gëzon shumë bashkëpunimi i AF me Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë në lidhje me organizimin e kurseve të gjuhës frënge për zyrtarët shqiptar që merren me marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, sepse nuk duhet harruar se frëngjishtja është njëra nga gjuhët e punës së BE-së.

Që prej 20 vitesh bilanci i AF të Tiranës është mbresëlënës : më shumë se 20.000 persona kanë ndjekur kurse gjuhe dhe civilizimi francez, më shumë se 2 000 vetë kanë marrë një diplomë të njohur në të gjithë botën.

Nën shembullin e Aleancës Franceze në Tiranë u ngritën në vend edhe tre Aleance franceze të tjera, në Korçë, Elbasan dhe Shkodër. Të katra ato tregojnë të njëjtin entuziazëm dhe kanë të njëjtat kërkesa për sa i përket cilësisë në veprimtarinë e tyre gjuhësore dhe kulturore. Përshendes me këtë rast presidentët dhe drejtorët që kanë ardhur të festojnë me ne datëlindjen e aleancës së tyre nënë, aleancës së Tiranës.

Falenderoj për mbështetjen e tyte të përhershme autoritetet shqiptare, në veçanti zotin Ministër të Arsimit, Zotin Kryetar të Bashkisë së Tiranës, të cilët janë këtu me ne sonte, si dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Që prej vitit 2006, Shqipëria është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.
Dëshira e qeverisë shqiptare të aderojë në ONF shpreh mbështetjen e saj për vlerat që mbron kjo organizatë ndërkombëtare, d.m.th. përtej gjuhës frënge që

kemi të përbashkët, vlerat e demokracisë, diversitetit kulturor dhe plurilinguiizmin.

I bëj sonte një thirrje qeverisë shqiptare, mësuesve të frëngjishtes dhe universitarëve. Të gjithë ju, së bashku me Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe Agjencinë Universitare të Frankofonisë, t'i japim gjuhës franceze në muajt në vijim vendin që ajo meriton në arsimin publik shqiptar dhe në bashkëpunimin universitar.

Ky aktivitet festiv shënon gjithashtu fillimin aktiviteteve të « Pranverës së frankofonisë. Ky festival kulturor, që vjen çdo vit me ditët e bukura, është përgatitur nga të gjitha ambasadat frankofone në Tiranë, nën presidencën e Ambasadës së Zvicrës, dhe natyrisht me një pjesmarrje të lartë të Aleancave Franceze dhe me mbështetjen e autoriteteve shqiptare. Shpresoj që të jeni sa më të shumtë në numër në aktivitetet e shumta kulturore dhe festive të parashikuara deri më 27 mars.

Jetë të gjatë Aleancës Franceze të Tiranës në 20-vjetorin e saj dhe e kalofshi sa më mirë.